



Monitorimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore

Bashkia Lezhë

VITI 2019

Ky raport është hartuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGJZH), në kuadrin e projektit “Ndërtimi i kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-ve) për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve të lidhura me reduktimin e dhunës në familje të “Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020”. Projekti zbatohet në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Për t’i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave”, financuar nga Qeveria e Suedisë dhe që po zbatohet nga UNDP, UN Women dhe UNFPA, në bashkëpunim me Qeverinë e Shqipërisë

Përmbajtja e këtij manuali është vetëm përgjegjësi e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim, dhe nuk reflekton opinionin e SIDA,UNDP, UNFPA dhe UN Women.

Autorët

Krista Fetaj, punonjese sociale

Esmeralda Hoxha, “Qendra Aleanca Gjinore per Zhvillim

Tabela e Permbajtjes

HYRJE	5
PËRSE MONITORIM I SKBGJ-SË NGA OSHC-TË?	6
METODOLOGJIA	6
MONITORIMI I QËLLIMIT TË III-TË STRATEGJIK TË STRATEGJISË KOMBËTARE DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE 2016-2020	8
GJETJET KRYESORE	8
TË DHËNA STATISTIKORE NË LIDHJE ME RAPORTIMIN E DHUNËS NË FAMILJE NË BASHKINË LEZHË	10
TË DHËNA STATISTIKORE NGA MEKANIZMI I REFERIMIT LEZHË	10
TË DHËNA STATISTIKORE NGA DREJTORIA E POLICISË LEZHË	11
TË DHËNA STATISTIKORE NGA GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LEZHË	11
REZULTATET E MONITORIMIT – VITI 2019	11
KONKLUZIONE	17
REKOMANDIME	18

Shkurtime

ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi Evropian
BGj	Barazia Gjinore
DhBGj	Dhunë me bazë Gjinore
DhF	Dhunë në Familje
GTN	Grupi Teknik Ndërdisciplinor
INSTAT	Instituti i Statistikave në Shqipëri
KONVENTA CEDAW	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
KONVENTA E STAMBOLLIT	Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
KD	Komiteti Drejtues
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
MShMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NBGj	Nëpunës i Barazisë Gjinore
NjVQV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
OShC	Organizatë e Shoqërisë Civile
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
QAGjZh	Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim
QZHK “Sot për të Ardhmen”	Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”
REVALB	Sistemi elektronik (on-line) i regjistrimit të rasteve të dhunës në Shqipëri
RrFGSh	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
SKBGj	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore
ShGPS	Shoqata e Grave me Probleme Sociale, Durrës
UM	Urdhër Mbrojtjeje
UMM	Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UN WOMEN	Entitet i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Hyrje

Ky raport u hartua në kuadër të Projektit “Ndërtimi i kapaciteteve të OShC-ve për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve në lidhje me zvogëlimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020, nën Programin e Përbashkët të KB "Përfundimi i Dhunës ndaj Grave" të financuar nga Qeveria e Suedia po zbatohet nga UNDP, UN Women dhe UNFPA në partneritet me Qeverinë shqiptare Në Shqipëri projekti u zbatua nga Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, nga disa nga anëtarët e Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri dhe disa organizata të tjera joqeveritare. Bashkitë e përfshira në monitorim ishin bashkitë e Lezhë, Kamëz, Fier, Sarandë dhe Pogradec.

Qëllimi i projektit është monitorimi i i detyrimeve ndërkombëtare dhe kombëtare të Shqipërisë për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe të gjitha formave të diskriminimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare, ndërsa rezultati i pritur në terma afatgjatë është ulja e fenomenit të dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe të gjitha formave të tjera të diskriminimit në Shqipëri. Proçesi monitorues i SKBGj dhe PKV 2016-2020 pr bashkitë e lartpërmenduar u zhvillua përgjatë periudhës nëntor 2019- Maj 2020. Aktivitetet në nivel qendror u monitoruan nga QAGjZh dhe në nivel lokal nga disa prej anëtareve të RrFGSh i dhe disa organizata të tjera, përmes mbledhjes së të dhënave zyrtare lidhur me zbatimin të Qëllimit strategjik 3 të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit 2016 – 2020.¹

Gjatë zbatimit të projektit u arrit që:

1. Organizatat partnere në projekt të rrisin për të monitoruar zbatimin e Objektivit të 3-të të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020 dhe punën e mekanizmave të referimit kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.
2. Proçesi i monitorimit nga u përfundua me sukses brenda afateve të zbatimit të projektit pasi edhe pse nën ndikimin e krizës COVID-19, institucionet përgjegjëse dërguan në kohën e duhur informacionet e kërkuara zyrtarisht.
3. U realizua proçesi i promovimit dhe advokimit, për zbatimin e objektivit të 3-të të SKBGj 2016-2020, duke përdorur gjetjet dhe rekomandimet e proceseve monitoruese.

Ky projekt, e nisi punën me organizimin e seancave informuese me përfaqësuesit e organizatave partnere në 5 bashkitë nën monitorim, bazuar në udhëzuesin për monitorimin e Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020, të realizuar nga GADC në nëntor 2019. Përveç manualit u hartuan skedat monitoruese bazuar në indikatorët për monitorimin e zbatimit të Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020, të cilat u përdorën gjatë procesit të monitorimit

Rreth organizatave zbatuese

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGjZh) është një organizatë jo-fitimprurëse shqiptare që vepron dhe punon në të gjithë Shqipërinë për fuqizimin e grave dhe për të krijuar një të ardhme të barabartë dhe

¹ <https://www.un.org.al/sites/default/files/SKGJB-AL-web.pdf>

të drejtë për vajzat dhe gratë me të ardhura të ulëta në të gjithë Shqipërinë, duke u përpjekur për t'i nxjerrë nga varfëria dhe përjashtimi. Për të mbrojtur të drejtat e grave dhe për t'i fuqizuar ato, QAGJZh ngrre fonde kombëtare dhe ndërkombëtare.

Fushat kryesore të ekspertizës së QAGJZh-së janë:

- Promovimi i paqes dhe përpjekjet për ti dhënë fund dhunës me bazë gjinore;
- Garantimi i fuqizimit ekonomik të grave;
- Sipërmarrjet e grave;
- Fuqizimi i qytetarëve për të monitoruar axhendën gjinore lokale;
- Rritja e përfaqësimit të grave në politikë dhe vendimmarrje;
- Përmirësimi i të drejtave të grave në zona rurale.

Gjatë procesit të monitorimit të bashkive Fier, Lezhë, Pogradec, Sarandë dhe Kamëz QAGJZh bashkëpunoi me një pjesë të organizatave të Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri - RrFGSh , si dhe me disa organizata të tjera të cilat veprojnë në territorin e bashkive nën monitorim si: Qendra Rinore Vlorë, Epoka e Re Fier, Tjetër Vizion Elbasan dhe Shoqata për Integrimin e Zonave Informale Kamëz.

Përse monitorim i SKBGj-së nga OShC-të?

Përgjegjshmëria në qeverisje është një element i rëndësishëm që përcakton marëdhëniet midis atyre që ushtrojnë fuqinë e pushtetit dhe atyre në emër të të cilëve ushtrohet kjo fuqi. Në sistemet demokratike, fuqizimi i sistemeve të transparencës dhe përgjegjshmërisë është prioritet i vazhdueshëm, që sigurohet përmes mekanizmave të ndërtuar, që përmirësohen vazhdimisht e që garantojnë pjesëmarrjen aktive në vendimmarrjen publike të shoqërisë civile, OShC-ve apo vetë përfaqësuesve të komuniteteve lokale. Këto mekanizma forcojnë proceset demokratike, sigurojnë zhvillim efektiv përmes dhënies së shërbimeve efektive, lehtësojnë procesin e mirëqeverisjes dhe fuqizojnë grupet më vulnerabël të komuniteteve, siç janë vajzat e gratë viktimat të dhunës në familje.

Ndërkohë që ligjet dhe strategjitë kombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e vajzave e grave dhe dhunën në familje/ me bazë gjinore janë hartuar me kontributin e vyer e të pakursyer të OShC-ve të grave, deri tashmë kjo rutinë nuk është shoqëruar me procese monitoruese e vlerësuese nga vetë OShC-të. Organizatat e grave në Shqipëri kanë të gjitha kapacitetet e nevojshme për të monitoruar dhe vlerësuar strategjitë dhe planet e veprimit në fushën që ato punojnë çdo ditë. Mbi të gjitha, ato për shumë vite kanë luajtur një rol vendimtar në adresimin e dhunës ndaj grave nëpërmjet ofrimit të shërbimeve, rritjes së ndërgjegjësimit, ngritjes së kapaciteteve, lobimit dhe avokimit, duke u bërë kështu aktorë kyç në nivel vendor e kombëtar.

OShC-të janë shumë të interesuara që të monitorojnë strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit, në mënyrë që të ketë një të kuptuar më të mirë të asaj që qeveria po bën në këtë drejtim. Qëllimi përfundimtar është që të zbatojmë një proces monitorimi të paanshëm që do të sigurojë një zbatim më të mirë të hapave të ardhshëm që do ndërmerren për reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe avancimin e barazisë gjinore në shoqëri. Vlen të theksohet se Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS), e ka mirëpritur këtë nismë dhe ka theksuar se ky monitorim nga shoqëria civile do të shërbejë për të informuar edhe procesin e monitorimit të brendshëm të SKBGj 2016-2020 nga institucionet përgjegjëse.

Metodologjia

Për të kryer monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2016-2020 dhe Planit të Veprimit u ndoq një qasje e dyfishtë metodologjike në mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore. Një

experte lokale u përzgjedh për çdo bashki të targetuar të ngarkuara për të ndjekur punën e bashkisë përkatëse dhe mbledhjen e të dhënave për periudhën janar – dhjetor 2019.

Procesi i mbledhjes së të dhënave është kryer si më poshtë vijon:

1. Mbledhja e të dhënave përmes takimeve informuese me zyrtarë lokal publik. Faza e parë ishte kontakti me kryetarët e bashkive të targetuara për njoftimin e tyre mbi iniciativën e monitorimit. Më pas monitorueset kontaktuan përmes një formati të njësuar koordinatorin vendor të dhunës pranë bashkisë dhe kurdo që ishte e mundur drejtorinë e shërbimeve sociale, drejtorinë e shëndetit, organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në territorin e bashkisë, zyrtarët e gjykatave të rrethit, komunitetet fetare, mediat, organizatat ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë të përfshirë në luftën kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Qëllimi i këtyre takimeve ishte vendosja e kontaktit që më pas u ndoq me kërkesa për informacion, të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera mbi punën e kryer nga bashkia dhe institucione të tjera për adresimin e objektivit të tretë të SKBGj për eliminimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Monitorueset gjithashtu kanë ndjekur takimet e zhvilluara në kuadër të mekanizmit të referimit në bashki dhe kanë raportuar mbi përmbajtjen e tyre dhe vendimet e marra.
2. Mbledhja e të dhënave përmes burimeve zyrtare e statistikore. Përmes të drejtës për informim monitorueset kanë kërkuar të gjithë dokumentet mbështetëse të punës së bashkisë në kuadër të luftës kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Specifikisht:
 - Janë mbledhur minutat mbi takimet e mekanizmit të referimit për çdo bashki, që kanë plotësuar informacionet e ndara me monitorueset përmes intervistave.
 - Janë marrë të dhëna statistikore mbi prevalencën e dhunës në familje nga gjykatat, shërbimi i provës, bashkia, policia, shërbimi social dhe INSTAT.
 - Është analizuar buxheti vjetor i bashkisë për të identifikuar burimet financiare të alokuara për zbatimin e SKBGj në luftën kundër dhunës në familje.
 - Janë mbledhur materiale mbështetëse për aktivitetet ndërgjegjësuese të zhvilluara nga ana e bashkisë për përmbushjen e objektivit 3.1.

Raporti i monitorimit ndjek strukturën e objektivave specifike të SKBGj sa i përket dhunës me bazë gjinore si edhe aktivitetet specifike të planit të veprimit. Për këtë është hartuar një skedë monitoruese e cila është plotësuar në vijimësi nga monitorueset përmes informacionit të akumuluar përgjatë periudhës monitoruese.

Bazuar tek skeda monitoruese është bërë vlerësim i përmbushjes së angazhimeve të bashkive të targetuara nën objektivin e tretë të SKBGj duke identifikuar nga njëra anë praktikat pozitive prej të cilave mund të përfitojnë edhe bashki të tjera dhe nga ana tjetër sfidat dhe mangësitë me të cilat përballen bashkitë, për të identifikuar mundësitë për përmirësim në periudhën e mbetur të planit të veprimit të SKBGj.

Për të kryer monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore janë përdorur edhe të dhënat e sistemit REVALB. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me mbështetjen e UNDP ka hartuar dhe miratuar bazën e nevojshme ligjore për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Bashkërendimit të Punës dhe Referimit të rasteve të dhunës në familje në mënyrë që të parandalohen, raportohen dhe trajtohen me efektivitet rastet e dhunës në familje.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 334, dt 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij” përcakton midis të tjerave dhe detyrimet konkrete të institucioneve shtetërore përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave, raportimin dhe referimin e rasteve të dhunës në familje. Sistemi online në lidhje me statistikën për

menaxhimin e rasteve të dhunës në familje ne nivel bashkie është lançuar në vitin 2014. Ky sistem online regjistron çdo rast dhune, monitoron si po ecën referimi i rastit dhe ku ka ngecur ai, duke siguruar që t'i shkojë deri në fund çdo rasti të raportuar të dhunës në marrëdhëniet familjare. Sistemi online është i sigurt dhe respekton fshehtësinë e të mbijetuarave të dhunës. Ai përdoret nga një numër i kufizuar i nëpunësve vendorë dhe qendrorë, të cilët janë trajnuar posaçërisht për përgjigjen ndaj dhunës në familje, fshehtësinë e të dhënave të së mbijetuarës dhe për përdorimin e sistemit. Ky sistem aksesohet nga të gjitha bashkite ne nivel lokal dhe MShMS në nivel qendror në adresën www.revalb.org

Mbi bazën e të dhënave të hedhura, sistemi prodhon raporte interaktive dhe të mundshme për t'u printuar në kohë reale të cilat kontribuojnë në: hartimin e politikave; matjen e efektivitetit të Grupeve Teknike Ndërdisciplinore (GTN) të ngritura në nivel lokal; përmirësimin e të dhënave statistikore të rasteve të dhunës në familje në nivel lokal; në marrjen e masave për mirë-funksionimin e mekanizmit referues në të gjitha njësitë vendore; Kryerjen e analizave statistikore, për të identifikuar probleme si dhe fusha ku ka nevojë për ndërhyrje; për të shmangur të gjitha dyshimet për të dhënat e pavërteta ose shifrat e gabuara, që çojnë në rritjen e besimit dhe përmirësimin e shkallës së bashkëpunimit midis aktorëve dhe të atyre që përfitojnë prej saj.

Të dhëna të përgjithshme Bashkia Lezhë

Sipas Censusit të vitit 2011, Lezha ka 65,633 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 106,245 banorë. Me një sipërfaqe prej 509.1 km² bashkia e re e Lezhës ka një densitet prej 208.69 banorë/km² sipas të dhënave të Regjistrimit Civil dhe 128.91 banorë/km² sipas Censusit 2011.

Kjo bashki përbëhet nga 10 njësi administrative, të cilat janë: Lezha, Shëngjini, Zejmeni, Shënkolli, Balldreni, Kallmeti, Blinishti, Dajçi, Ungreji dhe Kolshi. Të gjitha këto njësi janë aktualisht pjesë e rrethit të Lezhës dhe e po të njëjtit qark. Bashkia e re ka nën administrimin e saj dy qytete (Lezhë dhe Shëngjin) dhe 65 fshatra.

Monitorimi i Qëllimit të III-të Strategjik të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020

Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2019 në Bashkinë Lezhë.

Gjetjet kryesore

- Përgjatë vitit 2019 pranë komisariatit qendër Lezhë janë evidentuar 105 raste të dhunës në familje, 92 nga të cilat ishin gra/vajza.
- Gjatë periudhës janar - dhjetor 2019, sipas Ligjit 9669, datë 18.12.2006, nga policia e kësaj bashkie janë plotësuar 68 Kërkesë Padi për Urdhëra Mbrojtje dhe janë evidentuar 2 raste të shkeljes së Urdhrit të Mbrojtjes.
- Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë për vitin 2019 janë akorduar 94 Urdhëra Mbrojtje dhe Urdhëra të Menjëhershëm të Mbrojtjes
- Gjatë vitit 2019 Mekanizmi i Referimit kundër dhunës në familje pranë bashkisë Lezhë ka trajtuar rreth 15 raste.

- Koordinatorët vendorë të bashkisë Lezhë, fokusin e aktiviteteve të dhunës në familje e kanë gjatë 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore.
- Gjatë 2019 nga MKR Lezhë janë organizuar rreth 20 aktivitete me fokus dhunën në familje dhe atë me bazë gjinore.
- Buxheti për gjithë aktivitetet është mundësuar nga organizatat e ndryshme që operojnë në qytetin e Lezhës, megjithëse kjo bashki ka një fond të veçantë, materialet ndërgjegjësuere ofrohen nga OSHC-të që operojnë në territorin e kësaj bashkie.
- Gjatë 2019 janë realizuar 10 aktivitete në bashkëpunim me organizata të ndryshme që operojnë në qytetin e Lezhës si me Mary Ward Loreto, Strehëza për Gra e Vajza, Terre des hommes, World Vision.
- Në marrëveshjen mes bashkisë dhe institucioneve për Mekanizmin e Referimit, është përfshirë dhe Mary Ward Loreto dhe Strehëza për Gra e Vajza.
- Gjatë vitit 2019 janë organizuar dy trajnime me të gjithë aktorët e mekanizmit
- Bashkia ka bashkëpunim të vazhdueshëm me Kishën Ungjillore Lezhë me qëllim ofrimin e pakove ushqimore për rreth 6 muaj për çdo familje me një prind.
- Qendra rezidenciale fetare në Tale Lezhë “Laura Vikunja” ka ambiente ku janë strehuar për raste emergjente gra me fëmijë e me urdhër mbrojtje.
- Strehëza emergjentë “Rosalba”, gjithashtu me bazë fetare, ka strehuar për disa kohë raste të vajzave nën 18 vjeç me probleme sociale.
- Çdo 3 muaj organizohet një takim me GTN ku përshkruhen rastet që janë ndjekur gjatë periudhës. Mbledhjet e Grupit Teknik Ndërdisciplinor për vitin 2019 për rastet emergjente ishin 6, me përfshirjen e aktorëve të mekanizmit të referimit pranë kësaj bashkie, me një total prej 10 mbledhjesh gjatë vitit 2019.
- Në përgjithësi anëtarët pjesë e mekanizmit të referimit pranë kësaj bashkie janë prezentë në mbledhje, përjashtim këtu bëjnë përfaqësuesit e Gjykatës dhe Prokurorisë;
- Aktualisht nuk ka akses në sistemin online REVALB pasi është në rishikim si sistem. Në sistemin Revalb janë hedhur online vetëm rastet e muajve të parë të vitit, ndërkohë që më pas, ka qenë e pamundur që ky sistem të aksesohet.
- Përqindja e buxhetit të bashkisë Lezhë gjatë vitit 2019 i ka dedikuar shërbimeve sociale 2.1 % të vlerës totale. Ndërkohë që numri i grave, viktime të dhunës në familje të cilat kanë përfituar bonus qeraje për vitin 2019 ishte 5.
- Bashkia Lezhë ka 2 koordinatorë vendorë të cilat mbulojnë edhe barazinë gjinore.
- Buxheti i bashkisë Lezhë vetëm për dhunën: paga + aktivitete + materiale është 1.368.000 lekë.
- Komiteti Drejtues i MKR-së së bashkisë Lezhë për vitin 2019 nuk është mbledhur asnjëherë.
- Përgjatë vitit 2019, 111 ishin Urdhërat e lëshura nga Gjykata e kësaj bashkie për dhunuesit.
- Zyra Rajonale e Përmbartimit ka ndjekur dhe ekzekutuar 9 vendime në lidhje me Urdhërat e Mbrojtjes apo ata të Menjëhershëm të Mbrojtjes.
- Në bashkinë e Lezhës nuk ka një program përsa i përket dhënies së mundësisë për rehabilitimin e tyre nëpërmjet programeve të specializuara.
- Edhe Shërbimi i Provës rezulton të jetë jo funksional pranë kësaj bashkie.
- Në territorin e kësaj bashkie nuk ka as organizata të shoqërisë civile të cilat mund të ofrojnë shërbime të ngjashme në lidhje me plotësimin e objektivit të tretë të strategjisë.

Të dhëna statistikore në lidhje me raportimin e dhunës në familje në Bashkinë Lezhë

Të dhëna statistikore nga Mekanizmi i Referimit Lezhë

Gjatë vitit 2019 Mekanizmi i referimit kundër dhunës në familje pranë bashkisë Lezhë ka trajtuar rreth 15 raste. Disa prej rasteve paraqiten në tabelën ilustruese si më poshtë së bashku me përshkrimin dhe hapat e ndjekur nga MKR Lezhë.

Tabela. 1: Rastet e dhunës të trajtuara nga Mekanizmi i Referimit Bashkia Lezhë

Raste te trajtuara nga Mekanizmi i Referimit	Përshkrimi i rastit
Rasti 1:	Viktima 29 vjeç, nga një fshat i Mirditës është larguar nga shtëpia e prindërve për tu martuar me bashkëshortin e saj i cili e ka dhunuar sistematikisht për vite me rradhë. Ata kanë një vajzë 7 vjeç. Zonja gjen guximin ta denoncojë dhe të kërkojë Urdhër Mbrojtje ndaj tij. Bashkëshorti është nën arrest. Ndërkohë e dhunuara është dërguar pranë një qendre fetare për gra dhe vajza të dhunuara. Ajo kthehet në banesën e saj pasi nuk ndjehet më e kërcënuar. Vajza vazhdon shkollën rregullisht.
Rasti 2:	Viktima 17 vjeç, nga një fshat i Mirditës vjen të bashkëjetojë me një zotëri 40 vjeçar. Ai e dhunon sistematikisht dhe e dhunuara e denoncon dy herë në Komisarjatin e Policisë Lezhë. Ajo u akomodua në strehëzën emergjente për vajza deri në 18 vjeç. Më pas duke qënë së ndjehej e kërcënuar edhe nga familja e saj, është dërguar në qendrën rezidenciale për gra dhe vajza të dhunuara Kamëz.
Rasti 3:	Grua e martuar me 3 fëmijë dhe në pritje të një fëmije të katërt. Gjatë shtatëzanisë mes saj dhe bashkëshortit ka patur mosmarrëveshje ku më vonë kanë rënë dakort që gruaja të largohet nga banesa dhe fëmijët të qëndrojnë me babain e tyre. Pas disa ditësh bashkëshorti shkon në banesën ku ndodhej me qera dhe ai e dhunon fizikisht. Viktima merr një urdhër mbrojtje ndaj tij. E dhunuara dhe dhunuesi ndiqen vazhdimisht nga programet e shërbimit social dhe janë nën monitorim vazhdimisht.

Të dhëna statistikore nga Drejtoria e Policisë Lezhë

Përgjatë vitit 2019 pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë janë evidentuar 105 raste të dhunës në familje, nga të cilat 92 prej viktimave ishin gra dhe vajza. Ndërkohë që numri i rasteve të veprës penale “dhunë në familje” neni 130/a² për vitin 2019 ishte 30 dhe u arrestuan 16 autorë.

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2019, sipas Ligjit 9669, datë 18.12.2006, janë plotësuar 68 Kërkesë Padi për Urdhëra Mbrojtje dhe janë evidentuar 2 raste të shkeljes së Urdhrit të Mbrojtjes.

Detaje më të hollësishme pasqyrohen si vijon më poshtë:

Tabela 2: Dhuna në familje në Drejtorinë Vendore të Bashkisë Lezhë

Përshkrimi	Komisariati Lezhë
Evidentuar	105
Të dëmtuar gjithsej	115
Prej tyre gra/vajza	92
Kërkesë për U. Mbrojtje	68
Shkelje U.Mbrojtjes	2
V. P. Neni 130/a	30
Arrest. për 130/a	16
Ndaluar për 130/a	3
Gjendje të Lirë për 130/a	11
Në kërkim për 130/a	2
Autorë të vetëvrarë	0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Të dhëna statistikore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë

Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë për periudhën janar – dhjetor 2019 janë akorduar 94 Urdhra Mbrojtje dhe Urdhra të Menjëhershëm të Mbrojtjes.

Rezultatet e Monitorimit – Viti 2019

Objektivi 3.1 Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

² **Neni 130/a Dhuna në familje** (Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 17; ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr.144, datë 2.5.2013, neni 33) – 130/a1Rrahja, si dhe çdo veprë tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim gjer në dy vjet. 130/a2Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ishbashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim gjer në tre vjet. 130/a3Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim gjer në pesë vjet. 130/a4Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga një deri në pesë vjet.

Koordinatorët vendorë të bashkisë Lezhë, fokusin e aktiviteteve të dhunës në familje e kanë gjatë 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore që përkon në datat 25 nëntor deri me 10 dhjetor. Por, gjithashtu gjatë gjithë vitit realizohen aktivitete të ndryshme me fokus dhunën në familje dhe atë me bazë gjinore. Aktivitetet organizohen zakonisht me gra dhe burra të komunitetit në ambiente të ndryshme dhe me tema të ndryshme.

Marshimet gjithashtu janë pjesë e aktiviteteve të kësaj bashkie pasi kanë një impakt më të madh. Po ashtu edhe me mediat lokale përgjatë vitit 2019 kjo bashki ka patur bashkëpunime të ndryshme, për të publikuar spote të ndryshme me qëllim sensibilizimin e komunitetit mbi dhunën në familje.

Gjatë 2019 nga koordinatorët vendorë të dhunës në familje, janë kryer rreth 20 aktivitete me fokus dhunën në familje dhe atë me bazë gjinore

Buxheti për gjithë aktivitetet është mundësuar nga organizatat e ndryshme që operojnë në qytetin e Lezhës kryesisht Mary Ward Loreto, Terre des hommes dhe World Vision

Aktivitetet kanë qënë gjithëpërfshirës. Qëllimi i kësaj bashkie ka qënë që gjithmonë në aktivitete të përfshihen grupe të ndryshme të komunitetit, pasi që dhunën në familje e përjeton çdo target grup i shoqërisë. Por në aktivitete të posaçme ku i është përshtatur dhe temës dhe qëllimit të aktivitetit, janë përfshirë grupe ku pjesëmarrës kanë qënë burra dhe gra me probleme të ndryshme sociale si të papunë, emigrantë të rikthyer etj.

Numri i personave të përfshirë në aktivitet më të vogla është rreth 20 pjesëmarrës për çdo aktivitet ndërsa në aktivitetet madhore si p.sh marshime, kanë marrë pjesë grupe me nga 150 persona.

Gjatë 2019 janë realizuar 10 aktivitete në bashkëpunim me organizata të ndryshme që operojnë në qytetin e Lezhës. Organizatat që bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike me bashkinë Lezhë janë: Mary Ward Loreto, Strehëza për gra e vajza, Terre des hommes, World Vision.

Në marrëveshjen mes bashkisë dhe institucioneve për Mekanizmin e Referimit, është përfshirë dhe Mary Ward Loreto dhe Strehëza për gra e vajza.

Koordinatorët e dhunës në familje pranë bashkisë Lezhë kanë marrë disa trajnime sa i përket barazisë gjinore dhe gjithashtu në lidhje me ndryshimet e reja të ligjit nr 9669.

Trajnimet e marra nga Koordinatorët vendorë të dhunës dhe Barazisë Gjinore.

- Takim Rajonal të Koordinatorëve Vendorë kundër Dhunës në Familje;
- Takim me Njësitë Administrative për udhëzimet e ligjit të ri kundër Dhunës në Familje;
- Trajnim pranë ASPA për statusin e nëpunësit civil;
- Tryezë e rrumbullakët mbi sfidat e gjithëpërfshirjes për sensibilizim për fëmijët me spektrin e Autizmit në shkollat/institucionet përkatëse;
- Takim Rajonal të Koordinatorëve Vendorë kundër Dhunës në Familje
- Trajnim mbi 'Parandalimin e diskriminimit si dhe për mbrojtjen e të drejtave të personave LGBTI në Shqipëri';
- Policia në shërbim të komunitetit për trajnimin dhe parandalimin e rasteve të dhunës në bashkinë Lezhë;

- Trajnim për antarët e KRAT dhe Tryezës teknike kundër trafikimit të qënieve njerëzore;
- Pjesëmarrje në trajnimin e dates 8 Maj nga Komiteti i Helsinkit Holandë dhe COC Holande për parandalimin e diskriminimit të komunitetit LGBTI në Shqipëri;
- Puna sociale e decentralizuar në Shqipëri – Mbështetja për fëmijët, të rinjtë dhe familjet nga organizata ‘Ndihmë për fëmijët’.

Ndërkohë që janë organizuar dy trajnime me të gjithë aktorët e mekanizmit. I pari u realizua në ambientet e bibliotekës të bashkisë Lezhë, e organizuar nga një projekt i fituar në Shkodër ku në thelb dhe si qëllimi kryesor ishte “Policimi në Komunitet”. Një trajnim tjetër është organizuar nga Strehëza për gra e vajza mes koordinatorëve të dhunës të bashkisë Lezhë dhe anëtarëve të tjerë të mekanizmit të referimit, me temë “Funksionimi i mekanizmit të referimit dhe qasja ndërsektoriale” datë 15 tetor 2019.

Kjo bashki ka patur vazhdimisht bashkëpunim me Kishën Ungjillore që ndodhet në Lezhë me qëllim ofrimin e pakove ushqimore për rreth 6 muaj për çdo familje me një prind.

Gjithashtu qendra rezidenciale fetare në Tale Lezhë “Laura Vikunja” ka ambiente ku janë strehuar për raste emergjente gra me fëmijë e me urdhër mbrojtje.

Srehëza emergjentë “Rosalba”, gjithashtu me bazë fetare, ka strehuar për disa kohë raste të vajzave nën 18 vjeç me probleme sociale.

Tabela 4. Tabela e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore dhe datat e realizimit të tyre

Nr.	Data	Vendi	Tema	Organizuar nga
1	2.10.2019	Qendra ‘Jozue’	Takim për ditën botërore Jo Dhunës	Bashkia Lezhë
2	8.10.2019	Gjimnazi “Kolin Gjoka”	Dita ndërkombëtare e antitrafikimit	Bashkia Lezhë
3	23.10.2019	Njësia Zejmen	Dhuna në familje	Mary Ward Loreto dhe Bashkia Lezhë
4	3.11.20019	Ambjetet e rrobaqepësisë Kallmet	Takim me rrejtin e grave	Bashkia Lezhë
5	25.11.2019	Qendra komunitare multifunkionale	Takim informues mbi ligjin e dhunës në familje	Bashkia Lezhë

6	23.12.2019	Bar restorant "Jolly" Lezhë	Dhuna ne familje, ligji 9669	Bashkia Lezhë
---	------------	--------------------------------	------------------------------	---------------

Burimi: Bashkia Lezhë

Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Mekanizmi i Referimit pranë Bashkisë Lezhë është nënshkruar zyrtarisht me datë 26/11/2019 por që de facto ka funksionuar dhe më përpara nënshkrimit por për arsye subjektive nuk ka pasur një marrëveshje të nënshkruar. Mekanizmi ka si qëllim koordinimin dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të autoriteteve përgjegjëse në territorin e Bashkisë Lezhë për trajtimin e çështjeve të dhunës në familje. Grupi Teknik Ndërsektorial është ai i cili merret me menaxhimin e rasteve të dhunës në familje.

Rastet e trajtuara gjatë 2019 janë 15 dhe këtyre rasteve ju është ofruar që nga asistenca psiko-sociale, ligjore, ekonomike dhe strehim.

Çdo 3 muaj organizohet një takim me GTN ku përshkruhen rastet që janë ndjekur gjatë periudhës

Aktualisht nuk ka akses në sistemin online REVALB pasi është në rishikim si system, problematikë kjo e paraqitur edhe nga bashki të tjera.

Përqindja e buxhetit të bashkisë Lezhë gjatë vitit 2019 i ka dedikuar shërbimeve sociale 2.1 % të vlerës totale. Ndërkohë që numri i grave, viktime të dhunës në familje të cilat kanë përfituar bonus qeraje për vitin 2019 ishte 5. Gjatë vitit 2019 janë 51 gra, viktime të dhunës në familje të cilat përfitojnë ndihmë ekonomike nga vendimet UM dhe UMM pranë kësaj bashkie. Vlera për secilën prej tyre është 3000 lekë në muaj.

Bashkia Lezhë ka 2 koordinatorë vendore të cilat mbulojnë edhe barazinë gjinore. Koordinatorj ka kontratë në bazë të kodit të punës si çdo specialist tjetër i institucionit. Njëra koordinatorë është me statusin e nepunësit civil ndërsa tjetra është me kontratë por në proces për statusin.

Buxheti i bashkisë Lezhë vetëm për dhunën: paga + aktivitete + materiale është 1.368.000 lekë.

Gjatë vitit 2019 edhe për shkak të ndryshimeve të reja ligjore dhe futjes së Urdhrit Paraprak të Mbrojtjes së Menjëhershme (UPMM) bashkëpunimi i bashkisë Lezhë me policinë ka qënë edhe më i ngushtë dhe më i frytshëm.

I njëjti bashkëpunim korrekt është ndjekur edhe me Zyrën e punës, sidomos për ndjekjen e rasteve të punësimit dhe të kurseve profesionale, sidoqoftë nuk ka të dhëna të sakta për numrin e grave viktime të dhunës në familje që janë punësuar.

Bashkëpunimi me Drejtorinë Arsimore Rajonale vazhdon të jetë i ngushtë dhe dobiprurës për ndjekjen e rasteve të fëmijëve që kanë qënë të përfshirë në dhunën në familje.

Ndërkohë që Shërbimi Social është një prej hallkave kryesore dhe me një bashkëpunim të vazhdueshëm për ndjekjen e rasteve të cilat kanë kërkuar dërgimin në qendra ose strehëza.

Edhe me Sistemin e Shëndetësisë bashkia e Lezhë ka patur një bashkëpunim korrekt për ndjekjen e rasteve si dhe në prezencën e këtij institucioni në mbledhjet e GTN-së.

Organizatat e Shoqërisë Civile që operojnë në territorin e bashkisë Lezhë kanë qënë gjithmonë prezente dhe bashkëpunuese në zgjidhjen e rasteve.

Mbledhjet e Grupit Teknik Ndërdisciplinor (GTN) për vitin 2019 ishin 10, (6 për raste emergjente dhe 4 takime periodike çdo tre muaj) me përfshirjen e aktorëve të mekanizmit të referimit pranë kësaj bashkie. Ndërkohë që në kuadër të ofrimit të shërbimeve për viktimat e dhunës, ky grup më i vogël në numër është mbledhur rreth 35 herë për të raportuar për vijueshmërinë e zgjidhjes së rasteve. Ndërkohë që Komiteti Drejtues i MKR-së së bashkisë Lezhë për vitin 2019 nuk është mbledhur asnjëherë.

Urdhrat e Mbrojtjes si dhe ata të Menjëherëshëm të Mbrojtjes plotësohen nga Komisariati i Policisë Lezhë. Gjatë vitit 2019, bashkia dhe organizatat nuk ka plotësuar urdhëra mbrojtjeje.

Në Strehëzën Kombëtare për Viktimat e Dhunës në Familje i ardhur nga bashkia Lezhë, është trajtuar një rast. *(Rasti i një vajze e cila është dhunuar nga bashkëjetuesi i cili ishte dhe i alkoolizuar. Vajza nuk mund të kthehej në familjen e origjinës pasi dhunohej dhe nga babai i saj.)*

Tabela 5. Numri i mbledhjeve të GTN-së ne vitin 2019 në Bashkinë Lezhë

Viti	Mbledhjet e GTN
2019	Mbledhja e parë – 14.2.2019
	Mbledhja e dytë – 20.2.2019
	Mbledhja e tretë – 19.3.2019
	Mbledhja e katërt – 7.6.2019
	Mbledhja e pestë – 15.10.2019
	Mbledhja e gjashtë – 14.11.2019

Burimi: Bashkia Lezhë

Tabela 6. Numri i mbledhjeve të KD-së sipas viteve në Bashkinë Lezhë

Viti	Mbledhjet e KD
2019	Nuk është mbajtur asnjë mbledhje gjatë vitit 2019

Burimi: Bashkia Lezhë

Tabela 7. Përbërja e Komitetit Drejtues të bashkisë Lezhë

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2019
Bashkia	Kryetar Pjerin Ndreu
Drejtoria e Policisë	Ferdinand Mara
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Ornela Naqellari
Prokuroria e Rrethit	Milan Laskaj
Drejtoria Arsimore Rajonale	Bardhok Pula
Drejtoria e Shëndetit Publik	Zoje Zefej
Zyra e Përmbartimit	Liza Çuni
Prefektura	-
Zyra e Punësimit	Fatmir Delishi

Burimi: Bashkia Lezhë

Tabela 8. Përbërja e GTN-së Bashkia Lezhë viti 2019

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2019
Bashkia	Marta Fetaj, Suada Nekaj , Desara Marku
Drejtoria e Policisë	Erba Leka, Inspektoret e Zonës
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Nuk ka përfaqësues
Prokuroria e Rrethit	Nuk ka përfaqësues
Drejtoria Arsimore Rajonale	Albina Gjini, Alma Shyti
Drejtoria e Shëndetit Publik	Maria Zefi ,Rita Osmani
Zyra e Përmbartimit	Nuk ka përfaqësues
Prefektura	Nuk ka përfaqësues
Kryetarët e Njësive Administrative	Vijnë administratorët social të Njësive përkatëse
Zyra e Punësimit	Mimoza Ndreca
Organizata Jo qeveritare	Aferdita Gjoni
Strehëzat për viktimat e dhunës	Marsela Allmuca
Komunitete fetare	Kisha Ungjillore 'Lajmi I Mire'
Dhoma e Avokatisë së Rrethit	-

Burimi: Bashkia Lezhë

Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin e tyre, përmes programeve të specializuara.

Përgjatë vitit 2019 111 ishin Urdhërat e lëshura nga Gjykata e kësaj bashkie për dhunuesit. Duhet patur parasysh që këto statistika përfshijnë të dhënat për të gjithë rrethin e Lezhës, duke qenë se gjykata nuk ofron të dhëna të ndara sipas vendbanimit, apo të dhëna të tjera që bëjnë diferencën. Sicc edhe dalë në pah nga monitorimi, ky është një prej institucioneve i cili nuk merr pjesë në mbledhje dhe për pasojë të pakta janë informacionet që janë arritur të mblidhen nga ky entitet.

Ndërkohë që Zyra Rajonale e Përmbartimit ka ndjekur dhe ekzekutuar 90 raste për pension ushqimor; 16 ekzekutime me objektiv pension ushqimor si dhe ka ekzekutuar 9 vendime në lidhje me Urdhrat e Mbrojtjes apo ata të Menjëhershëm të Mbrojtjes.

Në bashkinë e Lezhës nuk ka një program përsa i përket dhënies së mundësisë për rehabilitimin e dhunuesve nëpërmjet programeve të specializuara. Edhe Shërbimi i Provës rezulton të jetë jo funksional pranë kësaj bashkie.

Paralelisht, në territorin e kësaj bashkie nuk ka as organizata të shoqërisë civile të cilat mund të ofrojnë shërbime të ngjashme në lidhje me plotësimin e objektivit të tretë të strategjisë.

Konkluzione

- Janë 51 gra, viktime të dhunës në familje të cilat përfitojnë ndihmë ekonomike nga vendimet UM dhe UMM pranë kësaj bashkie dhe kanë vetëm këtë ndihmë burim të ardhurash. Vlera për secilën prej tyre është 3000 lekë në muaj, vlerë e cila është shumë simbolike dhe nuk plotëson as nevojat minimale të jetesës.
- Situata e funksionimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit pranë kësaj bashkie shfaqet e mirë dhe gjithëpërfshirëse, sidoqoftë, numri i rasteve të trajtuara nga ky mekanizëm është disa herë më i vogël sesa rastet e viktimave të dhunës në familje të evidentuara nga policia apo/dhe UM/UMM të lëshuar nga gjykata e këtij rrethi.
- Në këtë bashki janë dy nëpunëse të cilat kryejnë funksionet e koordinatores vendore dhe kjo është një praktikë shumë e mirë e cila duhet të ndiqet edhe nga bashkitë e tjera, sidomos nga bashkitë e mëdha.
- Megjithë mbledhjet e organizuara në mënyrë të rregullt nga GTN e kësaj bashkie, mos pjesëmarrja e anëtarëve të rëndësishëm siç janë Gjykata dhe Prokuroria sjell pengesa dhe vështirësi në trajtimin optimal të rasteve.
- Aktivitetet dhe materialet ndërgjegjësuere për komunitetin për të mos pranuar dhunën ofrohen nga OSHC-të megjithëse kjo bashki ka buxhet të alokuar për këtë zë. Është e paqartë se për çfarë përdoret meqënëse ai nuk ezaurohet për materialet ndërgjegjësuere.
- Për muaj me rradhë asnjë rast i evidentuar i dhunës në familje nuk është pasqyruar në sistemin REVALB, kjo për mos funksionim të sistemit. Ankesa dhe njoftime janë kryer në mënyrë të rregullt për rregullimin e tij dhe për të patur akses optimal për vijueshmërinë.
- Megjithëse kjo bashki nuk ka një program rehabilitimi për dhunuesit, nuk është marrë asnjë masë për të gjetur zgjidhje alternative.
- Shërbimi i Provës funksionon siç duhet, por në fokus të tij janë më së shumti fëmijët dhunues deri në moshën 18 vjeç, duke mos patur pjesë të praktikave edhe dhunuesit e grave dhe vajzave.
- Bashkia Lezhë, i akomodon viktimat e dhunës në familje pranë strehëzës së organizatës fetare, ndërkohë që vetë si institucion akoma nuk e ka ngritur një të tillë.

- Megjithëse nga intervistat dhe monitorimi është vënë re prezenca e spitalit Lezhë në mbledhjet e GTN-së, nuk ka statistika të qarta nëse viktimat e dhunës në familje pajisen me raport mjeko-ligjor dhe nëse ju kryhen egzaminime të tilla në rastin e dhunës përpara marrjes së UM/UMM.
- Bashkëpunimi I kësaj bashkie shfaqet shumë pozitiv dhe i mirë me Zyrën e Punës, por akoma ka mbetur sfidë punësimi I tyre, duke qenë se të vetmet mundësi punësimi mbeten fasoneritë që operojnë në territor. Por as për këtë pjesë të industrisë nuk ka të dhëna të sakta se sa gra apo vajza viktime të dhunës në familje janë punësuar pranë tyre.

Rekomandime

Në bazë të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore në bashkinë e Pogradecit për vitin 2019, më poshtë renditen disa rekomandime të cilat kërkojnë masa të menjëherëshme për të rregulluar funksionimin e Mekanizmit të Referimit kundër Dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Lezhë dhe adresimin e objektivit të tretë të SKBGJ, kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje:

- Rekomandohet që anëtarë të rëndësishëm të mekanizmit të referimit pranë bashkisë Lezhë, siç janë Gjykata dhe Prokuroria të caktojnë një person I/e cila do të ndjekë në mënyrë të rregullt takimet e GTN-së të thirrura nga koordinatorja pranë kësaj bashkie;
- Megjithëse bashkia ka një buxhet në lidhje me ndërgjegjësimin e komunitetit për shunën në familje, ai nuk përdoret duke qenë se materialet ndërgjegjëse ofrohen nga OSHC-të, ndaj rekomandohet që ky zë I buxhetit të vihet në përdorim dhe të shikohet mundësia se kundrejt cilit zë mund të alokohet;
- Sistemi REVALB ka patur problematika edhe për shkak të ndryshimit të ligjit dhe rifreskimit të tij, dhe prej muajsh asnjë prej rasteve të bashkisë Lezhë nuk është pasqyruar online, ndaj rekomandohet në mënyrë emergjente dhënia e aksesit për koordinatorët dhe funksionimi korrekt I këtij sistemi. Gjithashtu, edhe pasqyrimi I rasteve të prapambetura në këtë sistem;
- Rekomandohet që të shikohen mundësitë për programe të ndryshme për rehabilitimin e dhunuesve, pranë territorit të kësaj bashkie, ose lidhja e një marrëveshje me Zyrën për Djem dhe Burra në Shkodër;
- Shërbimi i Provës duhet të zgjerojë fokusin edhe tek dhunuesit e grave apo/dhe vajzave, duke qenë se më së shumti ky shërbim pranë bashkisë Lezhë është i fokusuar tek fëmijët dhunues nën moshën 18 vjeç.
- Rekomandohet një bashkëpunim edhe më i madh me drejtuesit e drejtorive apo insitucioneve anëtare të mekanizmit të referimit, deri në sigurimin që viktime është jashtë rrezikut nga dhunuesi.
- Megjithëse ofrohet një strehëz nga organizata fetare, bashkia Lezhë e ka domosdoshmëri patjen e një strehëze të veten. Kjo, sepse strehëza e ofruar nuk ka kapacitete mjaftueshme dhe përdoret më shumë për vajzat e reja, dhe ka vetëm një dhomë për rastet e grave, viktime të dhunës në familje.
- Punësimi I grave mbetet problematikë e madhe, sepse të vetmet mundësi punësimi janë fasoneritë që operojnë në territorin e Lezhës, ndaj rekomandohet së pari udhëzimi për formim profesional si dhe asistencë për viktimat gjatë muajve të formimit të tyre;
- Vetëm 5 viktime të dhunës në familje kanë arritur të përfitojnë bonus qeraje, ndaj është e nevojshme dhe rekomandohet që ato të jenë të parat që iu ofrohet ky shërbim;

- Rekomandohet që asistenca prej 3000 lekë / muaj të rishikohet, sepse nuk përmbush asnjë nevojë jetike dhe është e pamjaftueshme për gjithçka.

Për më shumë informacion në lidhje me këtë raport kontaktoni

Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”

E-mail: gadc@gadc.org.al

Adresa: Rr. “Abdyl Frasherî” Pallati 10/1, shk.1, ap.3, Tiranë